

# Raport nga Hulumtimi

Perceptimet e nxënësve, prindërve dhe zyrtarëve për të drejtën  
për arsimim, ngacmimin dhe diskriminimin në shkolla



Prishtinë, Dhjetor 2013



**Botues:**  
Organizata “Syri i Vizionit”

---

Ky raport ka dalë si rezultat i hulumtimit të zhvilluar në kuadër të projektit “Qeverisja me të drejtat e fëmijëve - monitorimi i konventës për të drejtat e fëmijëve” - i zbatuar nga Syri i Vizionit me përkrahje të Save the Children. “ Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorit dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë mendimet e Save the Children”.

# Përmbajtja

FALËNDERIM	4
1. HYRJE	5
2. METODOLOGJIA	6
3. ANALIZA E TË DHËNAVE	7
3.1. E drejta në arsimim	7
3.2. Ngacmimi	13
3.3. Mosdiskriminimi	16
4. REKOMANDIMET	19

## Falënderim

Ky raport u hartua falë kontributit të personelit dhe bashkëpunëtorëve të shumtë të përfshirë në hulumtim. Falënderim i veçantë shkon për drejtoreshën e shkollës fillore dhe të mesme të ulët "Naim Frashëri" në Prishtinë, znj. Drita Hyseni me bashkëpunëtorët znj. Sadeta Kasumi dhe znj. Merita Haxhiu Hashani; drejtorin e shkollës fillore dhe të mesme të ulët "Ramiz Sadiku" në Pejë, z. Arif Ademaj dhe mësimdhënësen znj. Vjollca Gjokolli; si dhe drejtoreshën e shkollës fillore dhe të mesme të ulët "Zekeria Rexha" në Gjakovë, znj. Yllka Juniku Shehu dhe mësimdhënëset znj. Elvane Caka, znj. Myrvete Mullaademi dhe znj. Dhurata Bejtullahu.

Gjithashtu duhet falënderuar edhe nxënësit e të tri shkollave dhe prindërit e tyre për gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në këtë hulumtim. Veçanërisht duhet falënderuar nxënësit e tri shkollave të cilët kanë qenë realizues të pyetësorëve: Lekë Morina, Aulona Behrami, Dua Zajmi, Albesa Mazrekaj, Leona Hoxha, Fortesa Berisha, Qendresa Azemi, Valdrina

Mullatahiri, Eliana Berisha, Eldiana Azemi, Endrit Bregaj, Rron Byci, Bajram Qorri, Donjeta Alijaj, Trina Hoti, Urim Shaqiri, Albin Hoxha, Riga Dibrani, Viktoria Berisha, Fazli Zabeli, Fat Uka, Endrit Osmanaj, Gjin Kastrati, Almir Ismaili, Fatjona Demaku, Elsa Dreshaj, Aida Redzepagic, Arbër Sylejmani, Dea Rexhëbogaj, Eldon Byci, Elona Sahiti dhe Rea Kurtaj.

Kontribut të veçantë ka dhënë edhe z. Petrit Tahiri, i cili është angazhuar në hartimin e pyetësorëve; mbajtjen e takimeve informative / punëtorive me fëmijët si dhe në analizën e të dhënave.

Falënderojmë edhe Drejtoritë e Arsimit, Drejtoritë për Shëndetësi, Koordinatorët për të drejtat e fëmijëve në komuna, Qendrat për Punë Sociale, Institucionin e Avokatit të Popullit (ombudspersonit), Policinë e Kosovës dhe Gjykatat për bashkëpunimin dhe kontribut në realizimin e hulumtimit.

## 1. Hyrje

Korniza ligjore në Kosovë, që nga Kushtetuta, përcjellë edhe me ligje tjera garanton respektimin dhe kujdesin për fëmijë. Megjithatë zbatimi i këtij legjislacioni nuk është në nivel të kënaqshëm.

Organizata “Save the Children” në partneritet me “Syri i Vizionit” është duke implementuar projektin “Qeverisja me të drejtat e fëmijëve - monitorimi i Konventës për të drejtat e fëmijëve” i cili ka për synim zhvillimin e njohurive mbi monitorimin e zbatueshmërisë së Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijëve në Kosovë.

Hulumtimi është realizuar përmes pyetësorëve dhe është zhvilluar në tri komuna të Kosovës, gjegjësisht në tri shkolla fillore dhe të mesme të ulëta: “Naim Frashëri” në Prishtinë, “Ramiz Sadiku” në Pejë dhe “Zekeria Rexha” në Gjakovë. Hulumtimi është bërë nga vetë fëmijët me përkrahje të stafit të projektit.

Nga të gjeturat e hulumtimit janë hartuar raporte në nivel komune si dhe një raport përmbledhës për tri komunat. Raportet bashkë me rekomandimet përkatëse do t’u dorëzohen të gjitha institucioneve në nivel lokal dhe atë qendror, të cilët merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Në takime të veçanta, raportet do t’i dorëzohet zyrtarëve komunalë për të drejtat e fëmijëve, Avokatit të Popullit, Qendrës për punë sociale, Policisë dhe institucioneve të tjera në secilën nga tri komunat.

Gjithashtu, këto raporte do t’u dorëzohen edhe shkollave në të cilat është bërë monitorimi, si dhe institucioneve relevante komunale.

Ky raport i monitorimit do t’i ndihmojë institucionet në përgjithësi dhe shkollat në veçanti që të ndërmarrin masa për të përmirësuar gjendjen e të drejtave të fëmijës duke krijuar një ambient të sigurt dhe miqësor për të gjithë fëmijët.





## 2. Metodologjia


Hulumtimi është zhvilluar përmes pyetësorëve që i kanë mbuluar të tri fushat: E drejta për arsimim, Ngacmimi dhe Mosdiskriminimi. Pyetësorët janë realizuar me fëmijë, prindër dhe me zyrtarë. Në secilën nga tre shkollat e përzgjedhura janë caktuar disa nxënës të cilët nën mbikëqyrjen e stafit të projektit i kanë realizuar pyetësorët.

Duke u bazuar në të dhënat statistikore për secilën nga tre shkollat, është përcaktuar mostra e hulumtimit. Në hulumtim janë përfshirë të gjitha paralelet e nivelit të mesëm të ulët (klasat VI-IX). Nga katër apo pesë nxënës (varësisht nga përcaktimi i mostrës) janë përzgjedhur në secilën paralele për të marrë pjesë në hulumtim. Përzgjedhja e fëmijëve brenda klasës është bërë duke shfrytëzuar ditarin e klasës, ku është përzgjedhur çdo i katërti apo i pesti nxënës sipas renditjes në ditar.

Hulumtimi është zhvilluar gjatë një ore mësimore ose pas orëve mësimore. Të gjithë nxënësve të përzgjedhur për pjesëmarrje në hulumtim u janë shpërndarë pyetësorët, duke u lënë kohë të mjaftueshme që t'i plotësojnë. Mbledhja e pyetësorëve është bërë në atë mënyrë që të sigurohet anonimiteti. Ndërkaq, pyetësorët për prindër u janë shpërndarë nxënësve në zarfe. Pyetësori për zyrtarë është zhvilluar përmes intervistave me zyrtarët, të cilat i kanë zhvilluar vetë fëmijët.

### 3. Analiza e të dhënave

Të dhënat në vazhdim pasqyrojnë perceptimet e 312 nxënësve, 238 prindërve dhe 38 zyrtarëve që kanë marrë pjesë në hulumtim. Në figurën 1 është paraqitur struktura gjinore e pjesëmarrësve në hulumtim.



**Figura 1. Struktura gjinore e respondentëve**

Nxënësit dhe prindërit pjesëmarrës në hulumtim janë të shkollës fillore dhe të mesme të ulët: “Naim Frashëri” në Prishtinë, “Ramiz Sadiku” në Pejë dhe “Zekeria Rexha” në Gjakovë. Zyrtarët që kanë marrë pjesë në hulumtim janë nga këto institucione: Policia e Kosovës, Drejtoria Komunale e Arsimit, Njësia për të Drejtat e Njeriut – Komuna e Pejës, Institucioni i Avokatit të Popullit. Të gjithë respondentët janë përgjigjur në tre pyetësor që kanë mbuluar tri fusha: E drejta në arsimim, Ngacmimi dhe Mosdiskriminimi.


#### 3.1. E drejta në arsimim

E drejta në arsimim është e garantuar me Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Po ashtu, kjo e drejtë është e garantuar edhe me legjislacionin e Kosovës. Në nenin 47, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thuhet “Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike<sup>1</sup> dhe “Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj”<sup>2</sup>.

Nga të gjeturat e hulumtimit del se fëmijët në masë të konsiderueshme janë në dijeni se e drejta për arsimim është pjesë e Konventës, por jo të gjithë janë në dijeni se kjo e drejtë garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pra, nga Figura 2 mund të kuptojmë se mesatarisht 20.7% e fëmijëve janë përgjigjur se nuk e dinë që e drejta për arsimim garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, po ashtu 3.2% prej tyre mendojnë se kjo e drejtë madje nuk është e garantuar. Krahasimi që shihet në figurë na bën të kuptojmë që ka dallim nga përgjigjet e shkollave të ndryshme.

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 47, pika 1, faqe 14


<sup>2</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 47, pika 1, faqe 14



**Figura 2. A është e garantuar e drejta për arsimim me Kushtetutën e Kosovës**

Situatë e njëjtë thuhet edhe me çështjen e shkollimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Nga Figura 3 shohim që nxënësit kanë mendime relativisht të ndryshme rreth asaj se fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të shkojnë vetëm në shkolla speciale. Këtu vërejmë një përqindje të lartë (41.8%) të fëmijëve të cilët mendojnë që fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të shkojnë vetëm në shkolla speciale, çka na le të kuptojmë që respondentët nuk janë të njoftuar rreth të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.


Mendime relativisht të ndryshme kanë dhënë edhe prindërit. Në Figurën 3 shihet krahasimi i përgjigjeve të nxënësve dhe të prindërve. Nga aty shihet se edhe prindërit në nivelin prej 39.3% mendojnë që fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të shkojnë vetëm në shkolla speciale. Po ashtu, edhe në përgjigjet nga zyrtarët ka mendime relativisht të ndryshme rreth kësaj çështje.



**Figura 3. Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të shkojnë vetëm në shkolla speciale / Krahasimi i përgjigjeve të nxënësve dhe prindërve**




Duke u nisur nga fakti që e drejta për arsimim nuk përfshin vetëm hartimin e legjislacionit që e garanton këtë të drejtë, por edhe krijimin e kushteve të përshtatshme që kjo e drejtë të jetësohet, më poshtë do të paraqesim perceptimet e nxënësve, prindërve dhe zyrtarëve për çështjen e sigurisë në relacionin shtëpi-shkollë, infrastrukturën shkollore, dhe po ashtu edhe për cilësinë e mësimdhënies dhe vlerësimin.



**Figura 4. Siguria e nxënësve ne relacionin shtëpi-shkollë**


Sa i përket sigurisë në relacionin shtëpi-shkollë, nga Figura 4 vërejmë që nxënësit ndjehen mjaft të sigurt gjatë këtij rrugëtimi, mirëpo është me rëndësi të theksohet që kemi një numër jo të vogël të nxënësve të cilët përbëjnë 13% të nxënësve të anketuar, të cilët nuk ndihen të sigurt dhe arsyeja kryesore që ata nuk ndihen të sigurt është mungesa e trotuareve dhe ekspozimi i tyre ndaj rrezikut nga automjetet dhe qentë endacak.



**Figura 4.1 Siguria e nxënësve ne relacionin shtëpi-shkollë / Krahasimi në bazë të shkollës**


Në figurën 4.1 kemi paraqitur krahasimin në mes të nxënësve nga tri shkolla të ndryshme. Nga këto të dhëna kuptojmë se në shkollën “Ramiz Sadiku” në Pejë duhet të intervenohet sa më shpejt sepse kemi thujse një përqindje të dyfishuar në krahasim me dy shkollat tjera.

Problemi i sigurisë së nxënësve në këtë relacion paraqitet edhe në Figurën 5, ku përveç qenve endacak, vërehet së siguria në komunikacion përbën rrezik të madh për fëmijët. Po ashtu edhe huliganët (6%) paraqesin rrezik sipas nxënësve të anketuar.



**Figura 5. Siguria e nxënësve në relacionin shtëpi-shkollë**

Problemin e sigurisë në relacionin shtëpi-shkollë të ndarë sipas shkollave e kemi paraqitur edhe në figurën 5.1. Aty vërehet se problemi i dhunës në mes të bashkëmoshatarëve është mjaft i përhapur në shkollën “Ramiz Sadiku” në Pejë, përderisa në shkollën “Zekeria Rexha” nuk e kemi as edhe një përgjigje të vetme për këtë problem, por, problemi i huliganëve duhet trajtuar në këtë shkollë.



**Figura 5.1. Siguria e nxënësve në relacionin shtëpi-shkollë / Krahasimi në bazë të shkollës**

Përgjigje të njëjta në këto pyetje thuajse kanë dhënë edhe prindërit dhe zyrtarët. Prindërit mendojnë që problemi kryesor me të cilin ballafaqohen fëmijët në relacionin shtëpi shkollë janë qentë endacak (55%). Po ashtu edhe trafiku shihet si problem serioz me të cilin nxënësit ballafaqohen thuajse çdo ditë (24.1%). Ndërsa si problem të tretë i shohin huliganët me nga 3.7%.

Perceptimet e nxënësve për infrastrukturën e shkollës janë paraqitur në Figura 6. Është shqetësues fakti që 54.9% respektivisht 80% e nxënësve të përfshirë në anketë mendojnë se nuk ka ujë të mjaftueshëm respektivisht tualetet janë të papastr.

Edhe perceptimet e prindërve për këto çështje janë të njëjta, 44% respektivisht 70.7% e prindërve mendojnë se nuk ka ujë të mjaftueshëm respektivisht tualetet janë të papastr.



Për të pasur një pasqyre edhe më të mirë për (pa) pastërtinë e tualeteve ne kemi shtruar edhe një pyetje në një sektor tjetër të pyetësorit. Ajo që bie në sy është konsistenca në përgjigje, sepse edhe në këtë pyetje fëmijët në masën më të madhe (41.9%) janë shprehur se gjendja e tualeteve në shkollën e tyre është e keqe, respektivisht shumë e keqe (22.6% respektivisht 19.3%).






Figura 6. Perceptimet e nxënësve për infrastrukturën e shkollës

Në pyetjen se sa ndiheni të lirë të shtroni pyetje apo të kërkonti sqarime nga mësimdhënësit kemi marrë këto përgjigje (shih Figura 7). Nga 312 fëmijë që janë përgjigjur në këtë pyetje, 70% konsiderojnë se ndihen të lirë të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë sqarime nga mësuesit/arsimtarët.




**Figura 7. Ndihe i/e lirë të bëj pyetje dhe të kërkoj sqarime nga mësuesit/arsimtarët**

65.7% e fëmijëve të përgjigjur në këtë anketë, mendojnë se mësimdhënësit i vlerësojnë drejt për punën e tyre. Përgjigjet e nxënësve në lidhje me të drejtën e shprehjes së lirë të mendimit dhe të drejtës për informacion bashkë me përgjigjet në këtë pyetje, në bëjnë të kuptojmë që në mase të konsiderueshme (mbi 58%) fëmijët janë të kënaqur me punën që bëjnë mësimdhënësit e tyre.



**Figura 8. Arsimtarët më vlerësojnë drejt për punën time**




### 3.2. Ngacmimi

Ngacmimi si dukuri manifestohet në mënyra të ndryshme, që nga etiketimet me emra të ndryshëm, përhapja e thashethemeve, përjashtimit nga grupi e deri te dhuna fizike. Faktorët që qojnë deri në paraqitjen e ngacmimit janë të ndryshëm. Përmes këtij pyetësi ne jemi munduar që të qesim në pah disa të dhëna për praninë e ngacmimit në shkollë.


Ajo që vërehet që në pyetjen e parë është se fëmijët nuk kanë njohuri të mjaftueshme për ngacmimin dhe për format përmes të cilave manifestohet. Vetëm 18.6% e fëmijëve pjesëmarrës në hulumtim janë deklaruar se veprimi i përjashtimit nga grupi i tij/saj, me qëllim të caktuar është ngacmim, ose, vetëm 26.8% mendojnë se dërgimi i përmbajtjeve jo adekuate (porosi, fotografi, video) përmes telefonit, kompjuterit dhe mjeteve tjera elektronike është ngacmim. Po ashtu, 29.1% e të anketuarve mendojnë se kontakti fizik që ka për qëllim lëndimin apo dëmtimin e një personi (goditje, shqelm, grushtim etj.) nuk është ngacmim.

Edhe pse nga Figura 9 mund të shihet se pjesa dërmuese e nxënësve (61%) mendojnë se trajtimi i barabartë i të gjithëve brenda klasës, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, kulturore, gjinore, fetare dhe sociale, e parandalon ngacmimin si dukuri, grupi i nxënësve që janë përgjigjur me nuk e di (20%) dhe ata që janë përgjigjur me jo (19%) nuk i vogël, andaj duhet të ndërmerren veprime konkrete që fëmijët të njoftohen dhe të vetëdijesohen përsa i përket problemit të diskriminimit.



**Figura 9. A e parandalon ngacmimin, trajtimi i barabartë i të gjithëve brenda klasës, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, kulturore, gjinore, fetare dhe sociale?**


Janë shqetësuese të dhënat nga Figura 10, ku del se mësime dhe nxënës përdorin mjaft shpesh fjalë fyese/nënçmuese (15% respektivisht 19.7%). Përderisa në pyetjet paraprake respondentët, nxënës dhe prindër, kanë deklaruar (nxënësit 59.8%; prindërit 62.6%) se etiketimi me emra të ndryshëm ofendues, ose shaka në lidhje me gjininë, personalitetin, fenë, etninë, statusin socio-ekonomik, apo për mënyrën se si duken, konsiderohet si ngacmim, atëherë përdorimi i fjalëve fyese nga ana e tyre deri në masën 54.3% (kumulativi i shpesh dhe ndonjëherë – nxënësit) del të jetë i qëllimshëm.



**Figura 10. Në klasën time përdorin fjalë fyese/nënçmuese nga mësime / nxënësit**


Të gjeturat e pyetjes pasuese po e vërtetojnë në një mënyrë rrjedhën e deritanishme të përgjigjeve. Aty mund të vërehet se 61.1% e nxënësve dhe 41.7% e prindërve, mendojnë se ngacmimet janë të pranishme në klasën e tyre respektivisht fëmijëve të tyre.

Më herët u tha se ngacmimi mund të manifestohet në mënyra të ndryshme. Përdorimi i dhunës si forma më ekstreme e ngacmimit pasqyrohet në Figurën 11. Këto të dhëna janë shqetësuese sepse 15.7% e nxënësve mendojnë se arsimtarët përdorin dhunën fizike si mjet ndëshkimi. Shqetësues është edhe fakti që 8% e nxënësve mendojnë se janë viktimë të dhunës nga shokët dhe shoqet.



**Figura 11. Arsimtarët / Shokët dhe shoqet më ndëshkojnë fizikisht ose ushtrojnë dhunë ndaj meje.**

Të gjeturat nga pyetja se ku ndodh më së shumti ngacmimi (shih Figura 12), tregojnë se ngacmimet ndodhin apo zanafillën e kanë në oborr të shkollës (76.1%). Po ashtu edhe prindërit mendojnë se ngacmimet më të mëdha ndodhin në oborr të shkollës (76%).



**Figura 12. Ku ndodhin ngacmimet më të mëdha**

Nëse rastet e ngacmimit vijnë nga mësimdhënësit, prindërit kanë deklaruar se kanë ku të ankohen (55.5%). Mirëpo, në pyetjen pasuese se a merret parasysh kjo ankesë, një pjesë kanë refuzuar të përgjigjen (38%) ndërsa 21.4% kanë deklaruar se nuk merret parasysh.

### 3.3. Mosdiskriminimi

Në Kosovë ligji kundër diskriminimit (ref. nr. Ligji Nr.2004/ 3) ka për qëllim parandalimin dhe luftimi i diskriminimit, ngritjen e shkallës së barazisë efektive dhe realizimi i parimit të trajtimit të barabartë të personave në Kosovë para Ligjit. Të gjeturat e hulumtimit tregojnë se jo të gjithë janë në dijeni se ekziston një ligj i tillë, 23.2% e fëmijëve të anketuar janë shprehur se nuk e dinë se ekziston një ligj i tillë. Po ashtu, 23.6% e prindërve nuk janë në dijeni se ekziston një ligj i tillë.


Siç shihet në Figurën 13, 32% e nxënësve të anketuar mendojnë se diskriminimi është i pranishëm në klasën e tyre. Sipas nxënësve diskriminimi i bazuar në gjendjen ekonomike ndodh në nivelin 9.8%.

12.3% mendojnë se diskriminimi i bazuar në religjion është i pranishëm në klasën e tyre. Diskriminimi i bazuar në aftësitë e të tjerëve është në nivelin 13.6% sipas përgjigjeve të nxënësve.






Përqindjet në përgjigjet e prindërve në këto pyetje janë më të larta. Sipas tyre, diskriminimi i bazuar në gjendjen ekonomike është i pranishëm në nivelin 16.1%, pastaj diskriminimi i bazuar në religjion në nivelin 9.9% dhe diskriminimi i bazuar në aftësi të individëve është në nivelin 15.3%.




**Figura 13. Diskriminimi është i pranishëm në klasën time**

Të gjeturat e hulumtimit tregojnë se shkolla i plotëson kushtet që të gjithë fëmijët pa dallim të vijojnë mësimin. (shih Figurën 14)




**Figura 14. Shkolla ime i plotëson të gjitha kushtet për të vijuar mësimin me rregull për të gjithë fëmijët, pa dallim etnie, race, religjioni**

Po ashtu brenda shkollës dhe brenda klasave ekzistojnë mekanizma përmes të cilave trajtohen rastet e paraqitjes së diskriminimit. Ankesat zakonisht drejtohen tek kujdestarët e klasës dhe te drejtori. Po ashtu, nxënësit kanë deklaruar se edhe në nivel klase kanë rregullore që sanksionon diskriminimin (shih Figurën 15 dhe Figurën 16). Mirëpo, në përgjithësi përshtypjet e nxënësve janë që këto rregullore nuk janë aq funksionale dhe se duhet bërë avancime, e në mënyre të veçante duhet te ngritët vetëdija e të gjithëve për të implementuar dhe respektuar këto rregullore.



**Figura 15. A keni ku të ankoheni nëse ndodh ndonjë rast i diskriminimit**




**Figura 16. Në klasën tuaj, a keni ndonjë rregullore që e dënon dhe sanksionon diskriminimin**

## 4. Rekomandimet

Në bazë të të gjeturave del se edhe pse përgjithësisht ka përmirësime në kontekstin e punës në tri fusha që kanë qenë objekt i studimit, duhet të ndërmerren një varg masash për të përmirësuar edhe më tutje. Më poshtë do ti rendisim disa rekomandime që burojnë drejtpërdrejt nga të gjeturat e hulumtimit:

- » Organizimi i takimeve formale dhe joformale me qëllim informimin e fëmijëve, stafit të shkollës dhe prindërve me dokumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë punë, por në veçanti me legjislacionin e Republikës së Kosovës.
- » Ngritja e bashkëpunimit të shkollës me DKA-në, dhe drejtoritë / departamentet tjera komunale me qëllim të trajtimit të problematikës së trafikut dhe qenve endacak si dy probleme me të cilat ballafaqohen nxënësit në relacionin shtëpi-shkollë.
- » Shkolla në bashkëpunim me DKA-ne dhe MASHT duhet të shoh mundësinë për të përmirësuar gjendjen e tualeteve, sepse edhe nxënësit edhe prindërit e kanë identifikuar si një problem të madh.
- » Këshilli i shkollës në bashkëpunim me drejtorin duhet të funksionalizojë dhe fuqizojë mekanizmat e brendshëm shkollor, rregulloret, kodet etj.
- » Këshilli i shkollës në bashkëpunim me drejtorin, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të funksionalizojë dhe fuqizojë mekanizmat e brendshëm shkollor për të adresuar problemin e dhunës fizike dhe fjalëve fyese në klasë.
- » Shkolla në bashkëpunim me DKA-në dhe MASHT duhet të shoh mundësinë për të shtuar mbikëqyrjen e oborrit të shkollës dhe korridorit të shkollës, përmes sistemit të vëzhgimit elektronik (nëse ekziston vëzhgimi elektronik – të rritet mbikëqyrja), sepse nga të gjeturat konstatohet se oborri i shkollës dhe korridori janë dy vendet ku më së shumti ndodhin ngacmimet në mes të nxënësve.
- » Hulumtimi është realizuar vetëm në tri shkolla të tri qyteteve (Prishtinë, Pejë dhe Gjakovë), problemet e identifikuar janë probleme dhe sfida të këtyre shkollave dhe nuk guxojnë të gjeneralizohen në nivel komune, andaj, rekomandojmë që një hulumtim i tillë duhet të organizohet në nivel komune, apo edhe në nivel vendi.



Ky raport ka dalë si rezultat i hulumtimit të zhvilluar në kuadër të projektit “Qeverisja me të drejtat e fëmijëve - monitorimi i konventës për të drejtat e fëmijëve” - i zbatuar nga Syri i Vizionit me përkrahje të Save the Children. “ Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorit dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë mendimet e Save the Children.”